



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2024:017338
Datë: 27.12.2024
Numri i dokumentit: 06659064

C.nr.2164/2023

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, si kontestimore, me gjyqtarin individual Blerim Istrefi, në çështjen juridike të paditëses I.R. nga Mitrovica, të cilën e përfaqëson Fitim Gashi av me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës- Drejtoria Komunale e Arsimit, baza e kontestit: Kompensim të kualifikimit pa shkëputje nga puna, jashtë seance gjyqësore konform nenit 399 të LPK-së me datë 27.12.2024 nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET në tersi si e pabazuar kërkesëpadija e paditëses I.R. nga Mitrovica, me të cilën ka kërkuar që të **DETYROHET** e paditura Komuna e Mitrovicës- Drejtoria Komunale e Arsimit, t'ia paguajë paditëses, në emër të kompensimit 27% të pagës mbi bazë të kualifikimit-licencimit për periudhën kohore prej dt. 01.02.2021 e deri më 06.02.2023 apo për 24 muaj pune (për secilën muaj të pranisë në punë shumën nga 113.67 €), shumën e përgjithshme prej 2,728.08 €, me kamat ligjore prej 8 % nga data 27.12.2023 e deri në pagesën definitive të detyrimit, të gjitha këto në afat 7 ditorë nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësja, përmes të autorizuarës me datë 27.12.2023 ka paraqitur padi kundër të paditurës, për kompensim të shtesave në emër të licencimit duke u mbështetur në vendimin e Qeverisë me nr. 01/33 i dt. 29.08.2008, ku kanë kërkuar nga gjykata që ta obligoj të paditurën, që paditëses, në emër të kompensimit 27% të pagës mbi bazë të kualifikimit-licencimit për periudhën kohore prej dt. 01.02.2021 e deri më 06.02.2023 apo për 24 muaj pune (për secilën muaj të pranisë në punë shumën nga 113.67 €), shumën e përgjithshme prej 2,728.08 €, me kamat ligjore prej 8 % nga data 27.12.2023 e deri në pagesën definitive të detyrimit, të gjitha këto në afat 7 ditorë nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore pas shqyrtimit paraprak të padisë ka nxjerrë aktvendimin për përgjigje në padi më datë 28.10.2024, të cilin e paditura e ka pranuar (e cila është konfirmuar përmes fletë kthesave, të cila gjenden në shkresat e lëndës).

E paditura me përgjigje në padi e ka kontestuar kërkesëpadinë e paditëses si të pa bazuar dhe të pa argumentuar me prova, gjegjësisht paditësja nuk ka bashkangjitur provën – licencën për të vërtetuar faktin se është e licencuar ashtu siç parashihet në piken tre të vendimit të qeverisë, andaj ka kërkuar që e njëjta të refuzohet si e pa bazuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata pas analizimit të provave të cilat gjenden në shkresa e lëndës, dhe pasi arritjes së përgjigjes në padi, e duke u bazuar në nenin 399 të LPK-së, konstatoj se themelësia e kërkesëpadisë për paditësen I.R. nga Mitrovica nuk del nga faktet e treguara në padi, pasi që nga provat e ofruara nga pala paditëse vërtetohet fakti se për periudhën kohore për kompensim që kërkon me padi, nuk ka qenë e pajisur me licencë, e në rastin konkret që të kërkohej kompensimi ashtu siç parashihet me vendimin e qeverisë, si kusht bazë është qe pala të jetë e pajisur me licencë, që në rastin konkret paditëses i ka munguar, andaj gjykata vendosi si në të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata lidhur me shpenzimet e procedurës vendosi konform nenit 450 të LPK-së

Gjykata, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke i'u referuar dispozitës së nenit 399 dhe 450 të LPK-së, e në lidhje më dispozitat e vendimit të Qeverisë së RKS-së nr. 01/33 i dt. 29.08.2008.

Gjykata aktgjykimin e saj e bazoi ne nenin 143 par 1 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
C.nr.2164/2023 dt.27.12.2024

GJYQTARI
Blerim Istrefi

UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi, lejohet e drejta në ankesë, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj gjykate.